

## **GJYKATA E APELIT**

**Rasti: AC.nr.1469/2012**

**Data: 2 Gusht 2013**

**GJYKATA E APELIT** në shkallë të dytë nëpërmjet një kolegji të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si Kryetare e trupit gjykues, Gjyqtare MEDIHA JUSUFI dhe Gjyqtari NENAD LAZIĆ, si anëtarë të trupit gjykues;

Në rastin civil të paditësit RSM nga Podujeva kundër të paditurës KOMUNA e Podujevës për vërtetimin e pronësisë mbi banesën me vlerë të kontestit prej 12 500 Euro;

Pas pranimit të ankesës së parashtruar nga KOMUNA e Podujevës e paditur në shkallë të parë dhe ankuese në procedurat e shkallës së dytë, dhe ankesa e CB më parë nga Podujeva, aktualisht banon në Kurshumli, Republika e Serbisë, kundër aktgjkimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt 2009;

Pas diskutimit dhe votimit në një seancë të mbyllur të panelit të mbajtur në përputhje me Nenin 190, paragrafi 1, hipoteza e parë e Ligjit Nr 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare Nr. 38/2008), e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2012) ("LPK") e datës 2 Gusht 2013;

Me anë të kësaj sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika a), Neni 196 në lidhshmëri me Nenin 186, paragrafi 3 i LPK-së lëshon si në vijim

## **A K T V E N D I M**

**I.** Ankesa e së paditurës KOMUNA E PODUJEVËS kundër aktgjkimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale në Podujevë, me datë 2 Shkurt 2009 **HEDHET POSHTË** si e **PALEJUESHME** për shkak të tërheqjes së saj.

**II.** Ankesa e CB kundër aktgjkimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale në Podujevë, me datë 2 Shkurt 2009 **HEDHET POSHTË** si e **PALEJUESHME** si e parashtruar nga një person i paautorizuar pa interes juridik.

## **A R S Y E T I M I**

### **I. SFONDI PROCEDURAL**

**1.** Me datë 3 Nëntor 2008, RSM nga Podujeva si paditës ka parashtruar kundër KOMUNËS së Podujevës si e paditur një padi para Gjykatës Komunalë në Podujevë

me pretendime se duke qenë një punëtor i Komunës së Podujevës nga Janari i vitit 1971 e deri në Korrik të vitit 1990 (Çertifikata nr.03-726, me datë 7 Tetor 2008) atij i ishte ndarë banesa e cila ndodhet në Podujevë, Rruga "Zahir Pajaziti"nr.20, ndërtesa P+5/7, kati II, hyrja 2, që përbëhet nga 2 dhoma, 1 kuzhinë, 1 banjo, 1 tualet, 1 paradhomë, 1 korridor dhe 1 depo me Vendimin nr.04-360-1397, të datës 9 Tetor 1987 lëshuar në emër të tij dhe kontratës së nënshkruar mbi shfrytëzimin nr.282, me datë 3 Nëntor 1987. Meqë në vitin 1993 paditësi nuk ka mundur që ta privatizojë banesën meqë Serbët në mënyrë diskriminuese nuk ia kanë bartur atij, me anë të padisë, ai pretendon privatizimin e saj dhe njohjen e pronësisë së tij mbi të. Në *petitum* paditësi kërkon nga gjykata që ta vërtetojë se ai është pronari i banesës së sipërpërmendur dhe që ta obligojë Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona në Podujevë, ta regjistrojë në emër të tij.

**2.** Bashkangjitur me padinë ishte Çertifikata nr.03 - 726 lëshuar nga Drejtoria e Administratës dhe e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës me datë 7 Tetor 2008 për të vërtetuar që RSM ishte i punësuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës që nga viti 1970 e deri në Korrik 1971. Paraqitur po ashtu me padinë ishte edhe Vendim nr.04-360-1397 lëshuar nga Sekretari për Ekonomi - Kuvendi Komunal i Podujevës me datë 9 Tetor 1987 i bazuar në Nenin 32 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 11/83, 29/ 86 dhe 42/86), Neni 202 i Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 32/78) dhe Nenit 232 të Statutit të Komunës për ndarjen RSMT të banesës dy dhomëshe, nr.20 , kati 2 , hyrja 2, me një sipërfaqe prej  $52.51\text{ m}^2$  në rrugën "APJ", Ndërtesa P+5/7, Podujevë. Së fundi, bashkangjitur me padinë ishte kontrata për shfrytëzimin nr.282, e datës 3 Nëntor 1987 nënshkruar mbi bazat e Nenit 37 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore ndërmjet BVI-së - Drejtoria e Strehimit-Podujevë, si dhënëse e banesës dhe RSM-t si mbajtës i së drejtës së banimit.

**3.** Padia qe regjistruar për gjykimin e saj në C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale në Podujevë. Në procedurën e saj në shkallë të parë asnjë seancë paraprake nuk qe mbajtur sipas Nenit 401 të LPK-së. Shqyrtimi kryesor është mbajtur në një seancë me datë 2 Shkurt 2009 me pjesëmarrjen e RSM si paditës, personalisht, dhe KOMUNËS së Podujevës si e paditur, përfaqësuar nga MS – Bashkëpunëtore profesionale për kontestet juridike, autorizuar nga Kryetari i Komunës me autorizim Nr.01-1/08-02, lëshuar me datë 20 Janar 2009 sipas Nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale me qëllimin e përgjithshëm për të gjitha veprimet në procedurat para të gjitha gjykatave me pjesëmarrjen e Komunës së Podujevës dhe me vlefshmëri deri me datë 28 Shkurt 2009. Në këtë seancë paditësi e ka parashtruar padinë e tij, përfaqësuesja e së paditurës është përgjigjur, në

procedurën e provave dokumentet e bashkangjitura në padi qenë administruar dhe fjalimet përfundimtare qenë dëgjuar. Asnjë veprim tjetër procedural nuk është ndërmarrë në shkallë të parë, *inter alia*, për ndonjë precizim, ndryshim apo modifikim të padisë në aspektin e saj objektiv dhe/apo subjektiv.

4. Me aktgjykimin C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale në Podujevë, me datë 2 Shkurt 2009 qe aprovuar kërkesa e RSM dhe qe vërtetuar se ai është pronar i banesës e cila ndodhet në Podujevë, Rr.“Zahir Pajaziti” nr.20, Ndërtesa P+5/7, kati II, hyrja 2, që përbëhet nga 2 dhoma, 1 kuzhinë, 1 banjo, 1 tualet, 1 paradhomë, 1 korridor dhe 1 depo, ndërsa e paditura KOMUNA e Podujevës ka qenë e obliguar që ta njohë të drejtën e tij të pronësisë mbi këtë pronë dhe të lejojë ndryshimet në librat kadastral brenda 15 ditësh pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit. Ishte vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale. Sipas arsyetimit, RSM, pasi që i ishte ndarë banesa për nevoja të tija personale dhe familjare, në bazë të Nenit 2, paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore, bazuar në marrëdhënien e tij të punës me Komunën e Podujevës, ai e kishte pasur në posedim për më shumë se 10 vjet dhe andaj kishte fituar të drejtën mbi shfrytëzimin e saj të përhershëm, dhe në asnjë kohë pas kësaj, kontrata e tij mbi shfrytëzimin nuk mund të përfundojë duke u caktuar si mbajtës i së drejtës sipas Nenit 52 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore. Më tej, gjykata e shkallës së parë duke iu referuar Nenit 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 60/2000 se çdo e drejtë pronësie e fituar sipas ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e të fituarit, mbetet efektive përkundër ndryshimit të ligjit në fuqi në Kosovë, përpos kur e njëjta rregullore parasheh ndryshe. Kështu, nga të fituarit në mënyrë të përhershme mbi shfrytëzimin e banesës, në bazë të marrëdhënies së punës, posedimin e saj të vazhdueshëm, dhe pamundësinë e të paditurës si mbajtëse e së drejtës të heqë dorë nga kontrata mbi përdorimin e paditësit, ai është njohur si pronar i ligjshëm i saj.

5. Aktgjykimi C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale në Podujevë, me datë 2 Shkurt 2009 është shpallur sipas Nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK, më të shërbyerit e kopjeve të saja tek paditësi RSM me datë 26 Tetor 2009, dhe tek e paditura KOMUNA e Podujevës me datë 23 Tetor 2009, konfirmuar me dëftesat e pranimit sipas Nenit 121 të LPK-së.

6. Me datë 28 Tetor 2009, në emër të së paditurës KOMUNA e Podujevës, ishte parashtruar një ankesë C.Nr.2/2009, me datë 23 Tetor 2009, kundër aktgjykimit C.nr. 407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009 nga MS – Bashkëpunëtore profesionale për kontestet juridike. Arsyet e dhëna ishin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore sipas Nenit 181, paragrafi 2, pika a) e LPK-së, konstatimit jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike sipas Nenit

181, paragrafi 1, pika b) dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika c) e LPK-së. Kërkesa për shkallën e dytë ishte që të anulojë aktgjykimin e atakuar në tërësinë e saj me kthimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim .

**7.** Siç kërkohet nga Neni 187, paragrafi 1 i LPK-së , më 3 Nëntor 2009 një kopje e ankesës së parë i është shërbyer RSM personalisht, për përgjigje brenda 7 ditësh. Ajo ishte dorëzuar me datë 4 Nëntor 2009, brenda afatit të caktuar. Qëndrimi i shprehur ishte se aktgjykimi i kundërshtuar ka qenë i bazuar në ligj dhe provat e administruara në seancën kryesore, ndërsa ankesa nuk ipse ndonjë fakt apo prova të reja, nuk qe e shqyrtuar nga Gjykata Komunale në Podujevë dhe nuk është dashur që të parashtrohej vetëm për shkak se ajo ishte e lejuar. Më tej, RSM ka deklaruar se gjykata e shkallës së parë kishte gjetur masa diskriminuese të aplikuara kundër tij si një punonjës Shqiptar i larguar nga puna nga ana e forcave Serbe, dhe nuk iu ishte lejuar të marrë pjesë në privatizimin e banesës. Për bazën procedurale sipas Nenit 182, paragrafi 2 , pika a ) e LPK-së, e thirrur në ankesë, ai ka theksuar në përgjigjen e tij se meqë gjyqtari i procedurës Shaban Ganiu vdiq më 9 Shkurt 2009, rasti i ishte ricaktuar Gjyqtarit Muhammed Sadiku, që e përpiloj aktgjykimin.

**8.** Me datë 31 Dhjetor 2009, CB nga Kurshumlija, Serbi, ka parashtuar një ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër aktgjykimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, së datës 2 Shkurt 2009, duke theksuar se ai qe informuar jo zyrtarisht në lidhje me rastin që qe iniciuar nga RSM, një person i panjohur për të, kundër Komunës së Podujevës. CB më tej, duke pretenduar të jetë pronari ekskluziv legjitim i banesës së kontestuar dy dhomëshe, me një sipërfaqe prej  $52.51\text{ m}^2$  në Podujevë, Rruga “Nuhi Pajaziti” Nr.10 (P+P+7) dhe se në mënyrë të paligjshme i qe mohuar pronësia mbi të. Ai ka kërkuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë që të anulojë aktgjykimin C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt 2009 si tërësisht të paligjshme dhe që të ia njohë pronësinë e tij. Bashkangjitur me këtë ankesë të dytë ishte Vendimi Nr.04-360-345 i Departamentit të Ekonomisë, Urbanizmit, Shërbimeve të Strehimit dhe Çështjeve Pronësore-Juridike të Kuvendit Komunal të Podujevës, me datë 19 Nëntor 1992 për ndarjen me qira të banesës me sipërfaqe prej  $52.51\text{ m}^2$  në ndërtesën banesore P+P+7, kati II-të, nr.13, Rruga “JNA”, Podujevë– pronësi shoqërore e Komunës së Podujevës për CB-in si punëtor i Shkollës Filllore “Kosta Vojinovic” bazuar në Nenet 5 dhe 7 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Banesore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 50/1992). Bashkangjitur në ankesë ishte po ashtu kontrata nr.496, e datës 24 Nëntor 1992 e lidhur në mes të JSP (Kompania Publike Banesore) - Podujevë si qiradhënës dhe CB si qiramarrës për marrje me qira për një kohë të pacaktuar të banesës në Podujevë,

Rruga “JNA” nr.10 bazuar në Vendimin Nr.04-360-345, të datës 19 Nëntor 1992. Së fundi, qe prezantuar kontrata nr.360-88, me datë 11 Mars 1993 mbi blerjen e banesës nr.13 që ndodhet në Rrugën “JNA”nr.10, në Podujevë, me një sipërfaqe prej 52.51 m<sup>2</sup>, e që përbëhet nga 2 dhoma, 1 kuzhinë, 1 dhomë e ngrënies, 1 banjo me tualet, 1 parahomë, e lidhur në mes të Kuvendit Komunal të Podujevës si shitëse dhe CB si blerës, vërtetuar si Vr.nr.401/93 nga Gjykata Komunale e Podujevës me datë 12 Gusht 1993.

**9.** Sipas Nenit 188, parografi 1 i LPK-së ankesa e Komunës së Podujevës me datë 28 Totor 2009 dhe ankesa e CB-it e datës 31 Dhjetor 2009 qenë dërguar nga Gjykata Komunale e Lipjanit në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës dhe e regjistruar për gjykim si AC.nr.1446/09.

**10.** Me Aktvendimin ref.nr.2012.OPEJ.0100-001 të Nën-Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, në bazë të Nenit 5, parografi 1, pika c) dhe parografi 7 i Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Gazeta Zyrtare Nr. 27/08) ky rast i shkallës së dytë ishte marrë përsipër nga mandati ekzekutiv i EULEX-it dhe fillimisht i ishte caktuar një paneli të përzier të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, nën Nenin 5, parografi 2, fjalia e parë dhe paragrafët 4 dhe 5 të të njëjtit ligj.

**11.** AC.nr.1446/2009 i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës si e pa-kompletuar me datë 31 Dhjetor 2012, në pajtim me rregullën kalimtare të Nenit 39, parografi 1 i Ligjit Nr. 03/L-199 mbi Gjykatat (Gazeta Zyrtare Nr. 49/2011) me datë 1 Janar 2013 u bë rast *ex lege* e Gjykatës së Apelit dhe qe ri-regjistruar nën një numër të ri dosjeje – AC.nr.1469/12, evidentuar nga Letra GJ.a.nr.24/2013 e Gjykatës së Apelit, me datë 15 Shkurt 2013.

**12.** Me Vendimin ref.nr.2013.OPEJ.0279-001 të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, me datë 24 Qershor 2013, ky rast civil i shkallës së dytë qe ri-caktuar sipas Nenit 4, parografi 6 i Udhëzimeve për Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndët Civile, së fundi e ndryshuar me datë 11 Dhjetor 2012, tek një panel i përbërë nga Gjyqtarja e tanishme e EULEX-it si Kryetare e trupit gjykues dhe dy Gjyqtarë vendor si anëtarë të trupit gjykues. I fundit që caktuar nga Kryetari i Gjykatës së Apelit me Vendimin AGJ.nr.298/2013, të datës 17 Korrik 2013.

**13.** Duke qenë i përbërë ligjërisht në përputhje me kërkeshat specifike të Nenit 5, paragrafët 1, 4, dhe 5 të Ligjit nr 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, ky panel i Gjykatës së Apelit është autorizuar që të vendosë për rastin AC.nr.1469/12

bazuar në kompetencën e saj të përgjithshme të shkallës së dytë në rastet civile, sipas Nenit 15, paragrafi 2 i LPK-së dhe Nenin 18, paragrafi 1, nën-paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

## **II. PRANUESHMËRIA E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NË SHKALLË TË DYTË**

**14.** Në mënyrë për të qenë në gjendje të vendosin në lidhje me të dy ankesat e depozituara në AC.nr.1469/2012 të Gjykatës së Apelit mbi meritat, kolegji ka nevojë së pari të shqyrtojë nëse kërkesat ligjore për pranueshmërinë e tyre procedurale janë përbushur në lidhje me se cilën prej tyre. Nëse të vonuara, jo të plota apo të palejueshme, dhe të pa hedhura poshtë nga ana e shkallës së parë në bazë të Nenit 186, paragrafi 1 i LPK-së, ankesa duhet të hidhet poshtë nga ana e shkallës së dytë pa një seancë dëgjimore, në bazë të Nenit 196 të LPK-së.

### *Ankesa e KOMUNËS së Podujevës, me datë 28 Tetor 2009*

**15.** Ankesa e KOMUNËS së Podujevës nuk është e *vonuar* sipas Nenit 196, hipoteza e parë në lidhshmëri me Nenin 186, paragrafi 2 i LPK-së. Aktgjykimi C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale në Podujevë, me datë 2 Shkurt 2009 i ishte shërbyer kësaj pale në përputhshmëri me Nenin 107, paragrafi 1 dhe Neni 110, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së me datë 23 Tetor 2009. Ankesa e saj qe parashtruar me datë 28 Tetor 2009 në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës përmes Gjykatës Komunale të Podujevës në përputhje me Nenin 186 të LPK-së. Andaj duhet të konsiderohet si e parashtruar me kohë në përputhje me Nenin 127, paragrafi 1 i LPK-së, si e shërbyer në Gjykatë para periudhës kohore prej 15 ditësh, parashikuar nga Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së, kaluar nën kushtet e Nenit 126, paragrafi 5 i LPK-së me datë 9 Nëntor 2009.

**16.** Ankesa e KOMUNËS së Podujevës nuk është e *pakompletuar* sipas Nenit 196, hipoteza e dytë në lidhshmëri me Nenin 179, paragrafi 2 i LPK-së. Ajo përbën të gjitha kushtet e kërkua nga Neni 178, pikat a) - d) të LPK-së- një deklaratë e cila e specifikon aktgjykimin kundër së cilës është parashtruar, një mocion për ta ndërruar atë tërësisht, bazat për kundërshtimin e saj dhe nënshkrimin e përfaqësuesit të parashtruesit të ankesës.

**17.** Ankesa e KOMUNËS së Podujevës është *e palejueshme* sipas Nenit 196, hipoteza e tretë në lidhje me Nenin 186, paragrafi 3, hipoteza e tretë e LPK-së. Duke pasur parasysh statusin e këtij personi juridik-e paditur në shkallë të parë, ajo është parashtruar nga një palë, legjitimuar që të jetë ankuesi në shkallë të dytë sipas Nenit 176, paragrafi 1, shkallë e parë LPK, *e cila më pas është tërhequr nga ankesa e njëjtë*.

**18.** Gjatë rrjedhës për të marrë përsipër procedurën e zhvilluar sipas Nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përザgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe Nenit 3, paragrafi 6 i Udhëzimeve për Përザgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve për Gjyqtarët e EULEX-it në Lëndët Civile, së fundi e ndryshuar me datë 11 Dhjetor 2012, të gjitha palëve u qe dhënë mundësia për deklarata mbi bartjen e kompetencave të shkallës së dytë, në këtë rast tek EULEX-i. Me atë rast, KOMUNA e Podujevës me Parashtresën e saj me numër ref.nr.03/106-07, të datës 13 Nëntor 2012, ka deklaruar se me datë 25 Nëntor 2009 e ka *tërhequr* ankesën e saj kundër aktgjykimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 02 Shkurt 2009, për shkak të mungesës së legjimititetit pasiv meqë rasti veq qe zgjidhur nga Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore. KOMUNA e Podujevës më pas mori qëndrim se pavarësisht nga rezultati i çështjes së shkallës së dytë, për shkak të mungesës së legjimititetit të saj pasiv, asnje e drejtë dhe detyrim nuk mund të krijohet dhe të zbatohet për banesën me pronësinë e vendosur nga aktgjykimi i ankimuar. Parashtresa ref.nr.03/106-07, me datë 13 Nëntor 2012 qe nënshkruar nga FR - Bashkëpunëtor profesional për procedurat ligjore, bazuar në autorizimin Nr.02/166-02, të lëshuar nga Kryetari i Komunës së Podujevës, me datë 9 Korrik 2012, në pajtim me Nenin 58, pika b) të Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Nenit 56, pika b) të Statutit të Komunës, me qëllim të përgjithshëm dhe vlefshmëri deri me datë 31 Dhjetor 2012.

**19.** Meqë tërheqja e ankesës, e përmendur në parashtresën ref.nr.03/106-07, e datës 13 Nëntor 2012, e dorëzuar më 25 Nëntor të vitit 2009, nuk ka qenë e përfshirë në dosjen e lëndës dhe e regjistruar në regjistrin përkatës vjetor të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, për ta korrigjuar atë, KOMUNA e Podujevës ka parashtruar me datë 1 Gusht 2013 një parashtresë të re, ref.nr.03/87, me datë 31 Korrik 2013, duke theksuar në mënyrë eksplikite se në funksion të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore në vitin 2012, *ata tërheqin ankesën e tyre kundër aktgjykimit C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt, 2009*. Kjo tërheqje përputhet me kërkuesat për pranueshmërinë e saj. Në radhë të parë, sipas Nenit 177, paragrafi 1 i LPK-së, një palë mund të heqë dorë nga e drejta e saj/e tij për të parashtruar ankesë, që nga momenti kur aktgjykimi i është shërbyer atij/apo asaj; sipas Nenit 177, paragrafi 2 i LPK-së, parashtruesi i ankesës mund ta tërheqë ankesën nga gjykata e shkallës së dytë. Duke qenë e paditur në shkallë të parë - *parashtruesi i ankesës* në shkallë të dytë, KOMUNA e Podujevës, ka të drejtë me Nenin 177, paragrafi 2 i LPK-së që të bëj tërheqjen e ankesës së saj. Mjeti juridik ka qenë *asgjësuar* nga pala që e ka dorëzuar atë në përputhje me Nenin 3,

paragrfi 1 i LPK-së dhe liria e këtij asgjësimi e garantuar nga dispozita e njëjtë. Në rradhë të dytë, afati i caktuar nga Neni 177, paragrafet 1 dhe 2 të LPK-së për këtë veprim procedural, është respektuar. Tërheqja qe shpallur me datë 1 Gusht 2013 pasi që aktgjykimit C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 shkurt 2009, i qe shërbyer KOMUNËS së Podujevës me datë 23 Tetor 2009 dhe *para se* shkalla e dytë ta lëshonte vendimin e saj mbi ankesën. Andaj, tërheqja e saj e deklaruar me datë 1 Gusht 2013, përgjatë rastit jo të përfunduar në pritje AC.nr.1469/12, të Gjykatës së Apelit, është brenda afatit të dhënë nga Neni 177, paragrfi 2 i LPK-së dhe nuk është e vonuar. *Së treti*, duke qenë e shpallur jashtë seance, tërheqja është bërë nga një parashtresë, e parashtruar në Gjykatën e Apelit në formë të shkruar, siq kërkohet nga Neni 99, paragrfi 1, fjalia e parë e LPK-së me përbajtjen e parashikuar në Nenin 99, paragrfi 2, shkalla e dytë dhe paragrfi 3 i LPK-së. Nuk ka kushte të veçanta të kërkua nga Neni 177, paragrfi 2 i LPK-së. Prandaj, tërheqja nuk është e paplotë për shkak të mungesës së përbajtjes së detyrueshme, as nuk është përndryshe zyrtarisht e mangët. Duke qenë *ligjërisht* e parevokueshme sipas Nenit 177, paragrfi 3 i LPK-së nuk ishte *de facto* e revokuar nga ankuesi. Përkundrazi, ajo ishte në mënyrë identike e përsëritur tri herë nga kjo palë ndërgjygjëse – me datë 25 Nëntor 2009, 14 Nëntor 2012 dhe 1 Gusht 2013. *Së katërti*, tërheqja e ankesës është gjithmonë një veprim *i njëanshëm* i parashtruesit të ankesës. Pavarësisht nëse ka qenë e deklaruar më parë apo pasi që përgjigja në ankesë është parashtruar nga pala kundërshtare sipas Nenit 187, paragrfi 1 i LPK-së, pëlqimi i gjykatës së apelit- eksplisit apo i heshtur-nuk është një parakusht normativ për tërheqjen e ankesës që të prodhojë efektin e saj ligjor dhe/apo për gjykatën e shkallës së dytë ta hedhë poshtë atë sipas Nenit 195, pika a) dhe Neni 196 i LPK-së. Mjafton deklarata e ankimuesit për tërheqje të ankesës sipas Nenit 177, paragrfi 2 dhe Neni 186, paragrfi 3 i LPK-së, gjersa hedhja poshtë nuk varet nga pozita e ankuesit fare. Neni 261 i LPK-së është i pa-aplikueshëm-rregullon *tërheqjen e padisë* në shkallë të parë, gjersa *tërheqja e ankesës* në shkallë të dytë, është dhënë nga Neni 177, paragrfi 2 LPK-së. *Së pesti*, parashresa ref.nr.03/87, e datës 31 Korrik 2013 qe nënshkruar dhe parashtruar nga FR, përfaqësues i KOMUNËS së Podujevës në procedurat ligjore me Autorizimin Nr.02/114-02 lëshuar nga Kryetari i Komunës me datë 2 Prill 2013 sipas Nenit 58, pika b) e Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Neni 56, pika b) e Statutit të Komunës me fushëveprim dhe vlefshmëri deri me datë 31 Dhjetor 2013. Ky përfaqësim është i rregullt. KOMUNA e Podujevës si person juridik, sipas Nenit 5, fjalia e parë e Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale ka kapacitet procedural që të padisë dhe të jetë e paditur nëpër gjykata, në bazë të Nenit 5, fjalia e dytë, pika a) e Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Neni 73, paragrfi 1 i LPK-së. Nëpër procedura

mund të ndërmarrë veprime përmes përfaqësuesve të saj ligjor të caktuar nga ligji apo statuti - Neni 75, paragrafi 3 i LPK-së apo një përfaqësues i autorizuar - Neni 85, paragrafi 1 dhe Neni 89 i LPK-së. *Përfaqësuesi Ligjor* i KOMUNËS së Podujevës është Kryetari i saj i cili është edhe organi më i lartë ekzekutiv komunal, sipas Nenit 56 të Ligjit Nr.03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale, është fuqizuar nga dispozita e përgjithshme e Nenit 58, pika a) e të njëjtë ligj, dhe dispozita e posaçme e Nenit 58, pika a) e Statutit Nr. 01-1/298-10, me datë 12 Tetor 2009, me kompetenca për të përfaqësuar KOMUNËN e Podujevës dhe të veprojë në emër të saj. Duke qenë i caktuar në mënyrë eksplikite si përfaqësues ligjor i kësaj komune, si nga ligji i zbatueshëm dhe akti i tij i përgjithshëm, në pajtim me Nenin 75, paragrafi 3 i LPK-së, Kryetari është i autorizuar që personalisht të caktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në këtë rast - Neni 85, paragrafi 1 i LPK-së dhe shtrirjen e autorizimit - Neni 89 dhe Neni 90, paragrafi 1 i LPK-së. Në përputhje me këto rregulla, parashresa ref.nr.03/87, e datës 31 Korrik 2013 qe parashtruar me datë 1 Gusht 2013 në emër të KOMUNËS së Podujevës për tërheqje të ankesës në AC.nr.1469/2012 së Gjykatës së Apelit, nënshkruar nga FR, i autorizuar që ta përfaqësojë me Autorizimin Nr. 02/114-02 lëshuar nga Kryetari i saj i Komunës me datë 2 Prill 2013, në bazë të dispozitave të posaçme të Nenit 58, pika b) e Ligjit Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Neni 56, pika b) e Statutit të Komunës, si dhe normave të përgjithshme të Nenit 75 dhe Nenit 77, paragrafi 1 i LPK-së. Tërheqja është deklaruar para gjykatës së shkallës së dytë me datë 1 Gusht 2013 brenda kohës së vlefshmërisë së këtij autorizimi (2 Prill - 31 Dhjetor 2013). Është e përgjithshme në suazat për të gjitha procedurat para të gjitha gjykatave në të cilat KOMUNA e Podujevës është palë, si dhe për të gjitha veprimet procedurale gjatë rrjedhës së tyre. Edhe pse pala nuk e ka specifikuar në detaje këtë autorizim të përfaqësuesit të saj, i cili nuk është një avokat, nuk është i nevojshëm një autorizim shprehimor për tërheqje të ankesës sipas Nenit 91, paragrafi 1 i LPK-së. E aplikueshme është dispozita e posaçme e Nenit 91, paragrafi 2 i LPK-së që thotë se përfaqësuesi i autorizuar i një pale, që është *person juridik*, e që është pikërisht statusi i KOMUNËS së Podujevës në këtë rast, mundet edhe pa qenë avokat të i ndërmarrë të gjitha veprimet sipas Nenit 91, paragrafi 1 i LPK-së, duke përfshirë edhe tërheqjen e ankesës, *pa pasur nevojë për një autorizim shprehimor të saj*. Në përputhje me këtë, parashresa ref.nr. 03/87 e datës 31 Korrik 2013 ishte parashtruar në kohë nga FR për KOMUNËN e Podujevës tek Gjykata e Apelit me datë 1 Gusht 2013, bazuar në Autorizimin Nr. 02/114-02, me datë 2 Prill 2013 lëshuar nga Kryetari i Komunës e cila duke qenë e përgjithshme, e pa detajuar në mënyrë të rregullt e autorizon atë që vetë ta përpilojë ankesën e këtij ankimesit-personi juridik sipas Nenit 91, paragrafi 2 i LPK-së pa pasur nevojë për autorizim tjetër shprehimor, sipas

Nenit 91, parografi 1 i LPK-së. *Së gjashti* motivet e formuluara për këtë tërheqje të ankesës në lidhje me mungesën e legjitimitetit pasiv të KOMUNËS së Podujevës, ekzistimi i një vendimi përfundimtar të KKPB-së mbi kontestin, hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 04/L-61 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore janë të gjitha njësoj jo relevante. Neni 177, parografi 2 i LPK-së ia jep të drejtën parashtruesit të ankesës që lirisht të heqë dorë nga mjetet juridike të zakonshme të përdorura sipas Nenit 176, parografi 1, fjalia e parë, gjersa gjykata e shkallës së dytë nuk është e fuqizuar t'i shqyrtojë arsyet për këtë heqje dorë.

**20.** Duke e përbledhur, në pajtim me të gjitha kushtet e parapara ligjore përvlefshmérinë e tërheqjes së ankesës si një veprim i njëanshëm procedural i ankuesit, duke hequr dorë nga mjeti ligjor mbrojtës më parë i kërkuar në këtë procedim të shkallës së dytë dhe duke përjashtuar mundësinë për ndjekjen e saj të ardhshme në nivel të apelit. Ankesa është tërhequr *në tërësinë e saj kundër aktgjykit C.nr.407/08* të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt 2009. Prandaj, pas dorëzimit të saj në rrjedhën e procedurës në AC.nr.1469/2012 të Gjykatës së Apelit, ankesa e KOMUNËS së Podujevës, si e tërhequr është bërë e ndikueshme sipas Nenit 186, parografi 3, Hipoteza e tretë e LPK-së dhe si e tillë do të hedhet poshtë në bazë të Nenit 195, pika a) dhe Nenit 196 të LPK-së.

#### **Ankesa e CB, e datës 31 Dhjetor 2009**

**21.** Me datë 31 Dhjetor 2009, CB ka parashtruar përmes Gjykatës Komunale të Podujevës, për Gjykatën e Qarkut të Prishtinës ankesën e tij personale të nënshkruar kundër “aktgjykit/vendimit C.nr.407/08” për anulimin e saj dhe përbajtje tjera të dhëna në detaje në paragrin 8. Kjo ankesë e dytë është e palejueshme sipas Nenit 196 në lidhshmëri me Nenin 186, parografi 3, hipoteza e parë dhe e fundit e LPK-së sepse është parashtruar nga *një person i paautorizuar dhe pa interes juridik në parashtrimin e saj*.

**22.** Kapitulli XIII LPK rregullon *ankesën kundër aktgjykimeve si mjet i zakonshëm juridik* në procedurat kontestimore civile. Sipas Nenit 176, parografi 1, fjalia e parë LPK, vetëm *palët* mund të parashtronë një ankesë kundër një aktgjykimi të lëshuar në shkallë të parë, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që kopja e saj është shërbyer nëse një periudhë kohore është paraparë nga ligji aktual. Andaj, Neni 176, parografi 1, fjalia e parë e LPK-së, e titulluar “*E drejta e Ankimit*”, në mënyrë eksplikite dhe restrikтиве ia jep të drejtën *palëve* për këtë mjet të zakonshëm juridik vetëm në procedura, duke ia mohuar të gjithë personave tjerë fizik dhe juridik që nuk e kanë fituar statusin procedural të palëve ndërgjygjëse në rastin e caktuar civil. Në përputhje me këtë kufizim, në bazë të Nenit 176, parografi 2 i LPK-së vetëm një ankesë e

parashtruar në kohë nga një *person i autorizuar* do e pezullojë ekzekutimin e pjesës se ankimuar të aktgjykimit. Ankesa e personit të pa-autorizuar edhe në qoftëse është e parashtruar *de facto* nuk mund ta prodhojë këtë *efekt pezullimi* mbi hyrjen në fuqi të aktgjykimit të shkallës së parë dhe ekzekutimin e saj. Po ashtu nuk e ka *efektin e transferimit* sipas Nenit 176, paragrafi 3 i LPK-së duke bërë të transferuarit e autoritetit që të vendosë rastin mbi ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë tek gjykata e shkallës së dytë. Më tej, rregullat për pezullimin e ankesës nga të hequrit dorë nga e drejta për ta parashtruar atë, apo tërheqjen pas parashtrimit të saj, janë formuluar nga Neni 177, parrafët 1 - 3 të LPK-së në lidhje me *palët* në procedurë. Në mënyrë të njëjtë, të gjitha kërkesat për përbajtjen e ankesës sipas Nenit 177 të LPK-së, dhe për faktet e reja dhe dëshmitë për tu paraqitur dhe propozuar para gjykatës së shkallës së dytë sipas Nenit 180, parrafët 1-2 të LPK-së janë dhënë në lidhje me *ankuesin* që e ka parashtruar një ankesë të pranueshme, duke pasur *legitimitetin procedural* të paraparë në Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së dhe *interesin juridik* të kërkuar nga Neni 2, paragrafi 4 i LPK-së për ta kundërshtuar aktgjykimin e lëshuar në shkallë të parë, e pafavorshme për të drejtën(at) e saj materiale të pretenduar.

**23.** Ankesa e dytë në AC.nr.1469/2012 e Gjykatës së Apelit ka qenë *de facto* parashtruar nga CB, sidoqoftë, pa pasur të drejtë *de jure* për ankesë sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë LPK meqë në kundërshtim me këtë dispozitë *ai nuk ka qenë palë në procedurën e shkallës së parë* të kompletuar nga aktgjykimi C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt 2009. Pa e pasur këtë kapacitet procedural të palës, të kërkuar në mënyrë eksplikite nga Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së, CB nuk ka qenë i legitimuar që të iniciojë përmes një ankesë këtë procedurë të shkallës së dytë kundër aktgjykimit C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale në Podujevë me datë 2 Shkurt 2009 mbi ndonjërin nga arsyet e mundshme sipas Neneve 181 - 184 të LPK-së për kundërshtimin e saj me ndonjë mocion të mundshëm për ndryshimin e saj të plotë apo të pjesshëm.

**24.** CB nuk ka qenë *paditës* në rastin C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës. Padia për konfirmim të pronësisë mbi banesën në Podujevë, Rruga "Zahir Pajaziti", nr.20, ndërtesa P+5/7, kati II, hyrja 2, në këtë rast qe parashtruar nga RSM nga Podujeva *si paditësi i vetëm* në këtë çështje gjyqësore civile. Nuk ka asnjë dykuptimi së në individualizimin personal të RSMT apo statusin e tij procedural të dhënë në përbajtjen e duhur të padisë. Me parashtrimin e saj me datë 3 Nëntor 2008, në Gjykatën Komunale të Podujevës, në formë të shkruar të dhënë nga Neni 252 i LPK -së, RSM u bë *ex lege* paditësi në procedurën e kontestuar të inicuar nga ai sipas Nenit 2, paragrafi 1 i LPK-së. Padia më pas nuk qe *korrigjuar* sipas Nenit 102,

paragrafi 1 i LPK-së, *ndryshuar* sipas Nenit 257, paragrafi 1 në lidhshmëri me Nenin 258 të LPK-së apo *modifikuar* sipas Nenit 257 paragrafi 2 i LPK-së në asnjë moment dhe në asnjë formë, *inter alia*, në mënyrë që ta zëvendësojë RSM si paditës; ai po ashtu nuk qe *bashkuar nga një paditës* sipas Nenit 264, paragrafi 2 në një bashkëndërgjygjësi sipas Nenit 264, paragrafi 1 i LPK-së. CB nuk kishte parashtruar padinë C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale në Podujevë kundër RSM dhe KOMUNA e Podujevës duke pretenduar pronësi mbi të gjithë banesën e kontestuar nën kushtet e Nenit 266, paragrafi 1 i LPK-së - teorikisht dhe praktikisht është *përjashtuar* pramundësia për statusin e saj procedural të paditësit të fituar përmes *ndërhyrjes kryesore* në procedurë në shkallë të parë sipas Nenit 266, paragrafi 1 i LPK-së. Andaj, fushëveprimi subjektiv i kontestit ka mbetur i pandryshuar gjatë gjithë rrjedhës së rastit C.nr. 407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës-duke qenë e inicuar nga RSM ka qenë e gjykuar dhe është vendosur në lidhje me këtë person fizik, si paditës i vetëm në këtë rast. Përkundrazi CB *nuk ka qenë zyrtarisht i përfshirë* në C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës si *paditës* dhe nuk ka marrë pjesë *de facto* si i tillë në gjykimin e kontestit në shkallë të parë.

**25.** CB nuk ka qenë *i paditur* po ashtu në shkallë të parë. Padia në C.nr.407/08 e Gjykatës Komunale të Podujevës qe parashtruar kundër KOMUNËS së Podujevës si e vetmjë e paditur në këtë kontest. Padia është pa paqartësi ose parregullsi të tjera në lidhje me të - pjesa e saj e titullit në mënyrë eksplikite emëron KOMUNËN e Podujevës sipas Nenit 253, paragrafi 1, pika f) në lidhshmëri me Nenin 99, paragrafi 2 i LPK-së si personin juridik, në lidhje me të cilën, lëshimi i një aktgjykimi deklarativ mbi të drejtën e pretenduar të pronësisë është kërkuar sipas Nenit 254, paragrafi 1 i LPK-së. Në përputhje me këtë, *Lis Pendens* nën Nenin 262, paragrafi 1 i LPK-së qe përcaktuar përmes shërbimit të kësaj padie vetëm në lidhje me KOMUNËN e Podujevës. Sërisht, nuk ka qenë *e precizuar* sipas Nenit 102, paragrafi 1 i LPK-së, *ndryshuar* sipas Nenit 257, paragrafi 1 në lidhshmëri me Nenin 258 të LPK-së apo *modifikuar* sipas Nenit 257, paragrafi 2 i LPK-së – prandaj, qëllimi fillestar subjektiv i padisë nuk qe ndryshuar fare në rrjedhën e mëvonshme të procedurës së shkallës së parë dhe CB nuk qe bërë i paditur *në vend* të KOMUNËS së Podujevës. Po ashtu nuk ka pasur asnjë çështje gjyqësore të përbashkët mes tyre - *padia nuk qe fillimisht e parashtruar* kundër KOMUNËS së Podujevës dhe CB, si dy të paditur të ndarë nën kushtet e dhëna në Nenin 264, paragrafi 1 i LPK-së, *as që ishte zgjeruar më vonë* për të përfshirë CB-in si një i paditur shtesë sipas Nenit 264, paragrafi 2 i LPK-së. Gjykimi në C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale të Podujevës qe mbajtur duke respektuar këto kufij subjektiv të procesit gjyqësor të definuar nga padia me KOMUNËN e Podujevës duke qenë e paditura e parë dhe e fundit në të, dhe *vice versa*.

*versa* CB duke mos pasur vend *de jure* apo pjesëmarrje *de facto* të palës kundërshtare në kontestin e zgjidhur në shkallë të parë.

**26.** CB nuk ka qenë *palë e tretë* sipas Nenit 271, paragrafi 1 i LPK-së në shkallë të parë meqë asnë nga kërkesat obligative për fitimin e këtij statusi procedural të dhëna nga dispozita e Kapitullit XVII e LPK-së, nuk qenë përbushur. *Së pari*, në C.nr.407/2008 të Komunës së Podujevës, *nuk ka pasur asnë deklaratë* të CB-it për tu bashkuar si palë e tretë në procedurë, e parashtruar me shkrim apo e bërë gojarisht në seancën e datës 2 Shkurt 2009 sipas Nenit 271, paragrafi 3 i LPK-së;asnë deklaratë e tillë nuk i qe shërbyer paditësit RSM dhe/ose së paditurës KOMUNËS së Podujevës, sipas Nenit 271, paragrafi 3 i LPK-së për *kundërshtimet* sipas Nenit 272, paragrafi 2 i LPK-së;asnë aktvendim nuk ishte lëshuar që do e aprovonte pjesëmarrjen e CB-it si palë e tretë sipas Nenit 272, paragrafi 3 i LPK-së. Si pasojë, ky person fizik nuk ishte *bashkuar* në rastin C.nr. 407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës sipas Nenit 274, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së si një palë e tretë nëasnë fazë, e as që kishte ndërmarrë ndonjë veprim procedural sipas Nenit 274, paragrafi 1, fjalia e dytë e LPK-së në shkallë të parë në një kapacitet të tillë apo tjetër. Me pak fjalë, CB nuk kishte kërkuar vetë nëasnë mënyrë apo nëasnë moment gjatë rrjedhës së C.nr.407/08, e as që ishte pranuar nga Gjykata Komunale e Podujevës që të intervenojë si palë e tretë në mënyrë që të ndihmojë apo mbështes çdo palë ndërgjygjëse kryesore sipas Nenit 271, paragrafi 1 i LPK-së. Andaj, CB *nuk ishte bërë palë e tretë* në rastin C.nr. 407/08 të Komunës së Podujevës pas *intervenimit* në bazë të iniciativës së tij. *Së dyti*, as paditësi RSM e as e paditura KOMUNA e Podujevës nuk e kishin *përfshirë* CB-in si palë e tretë- ai asnëherë nuk qe njoftuar përasnë seancë në lidhje me rastin C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës. Prandaj,asnë ftesë sipas Nenit 276, paragrafi 2 i LPK-së nuk i qe dërguar apo shërbyer CB -it që të paraqitej para Gjykatës Komunale në Podujevë nëasnë fazë të gjykimit të rastit C.nr. 407/2008 para përfundimit të saj me datë 2 Shkurt 2009. Jo egzistente janë të gjitha kushtet paraprake të dhëna nga Neni 276, paragrafët 1-3 të LPK-së për përfshirjen e CB nga cilido prej ndërgjyqësve në këtë kontest. *Së terti*, meqë CB nuk ishte bërë palë e tretë në shkallë të parë *de jure* i palejueshëm dhe *de facto* e pa-shfrytëzuar ishte mundësia për të vepruar në procedura në vend të çdonjërit prej palëve kryesore, duke e zëvendësuar paditësin apo të paditurën dhe duke përjashtuar atë nga pjesëmarrja në procedurat e mëtejshme sipas Nenit 273, paragrafi 5 i LPK-së. Në përbledhje, *nuk ka as edhe një dokument* të vetëm në dosje që reflekton ndonjë pranim formal të CB-it si palë e tretë dhe/apo pjesëmarrjen e tij faktike në shkallë të parë në cilësinë e palës së tretë procedural.

**27.** Legjitimiteti i CB-it si parashtrues i ankesës nuk mund të arsyetohet me

statusin procedural të palës në këtë çështje gjyqësore *të fituar në shkallë të dytë* në mënyrë direkte. *Së pari*, statusi i tij i ankimesit në AC.nr.1469/12 të Gjykatës Apelit nuk mund të dilte siq kërkohet nga Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së nga statusi i tij si palë ndërgjygjëse në rastin C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës – meqë CB nuk ishte paditës, i paditur apo një palë e tretë në shkallë të parë, *ex lege* është e përjashtuar e drejta e tij për të vepruar si ankimesit në shkallë të dytë duke u bazuar në rregullën e përgjithshme të pa respektuar të Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së. *Së dyti*, kushtet për bashkimin e CB-it si palë e tretë në procedurat e shkallës së dytë në AC.nr.1469/2012 të Gjykatës së Apelit, nuk janë përbushur po ashtu. Ankesa e parashtruar nga CB me datë 31 Dhjetor 2009 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë përban vetëm bazat për kundërshtimin e aktgjykimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, me datë 2 Shkurt 2009, për një shkelje thelbësore të procedurave sipas Nenit 182, paragrafi 2, pika i) e LPK-së (mos pjesëmarrja në shqyrtimet gjyqësore nga ana e CB-it për shkak të mos ftuarjes) dhe aplikimin e gabueshëm të së drejtës materiale sipas Nenit 184 të LPK-së (e drejta e pronësisë që pretendohet se është fituar nga ai mbi banesën e kontestuar si pronar i saj ekskluziv i ligjshëm). Kërkesa në ankesë është për anulimin e aktgjykimit C.nr. 407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009 me refuzimin e padisë. Ankesa e tij, as tekstualisht as në referencë numerike në Nenin 271 të LPK-së nuk përfshin ndonjë deklaratë të CB-it për t'u *bashkuar* në procedurën e shkallës së dytë të inicuar me datë 28 Tetor 2009 me ankesën e KOMUNËS së Podujevës kundër aktgjykimit C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009. Në mungesë të një mocioni procedural të kërkuar nga Neni 271, paragrafi 3 i LPK-së- një kërkësë eksplicite me shkrim e CB-it për të intervenuar në shkallë të dytë si palë e tretë për të mbështetur njërin nga palët ndërgjygjëse, specifikuar në kërkësen e njëjtë me interes juridik në një ndihmesë të tillë, procedura e ndërhyrjes sipas Nenit 271 - 273 i LPK-së nuk mund të konsiderohet si e inicuar, andaj, nuk është dashur që të zhvillohet dhe të vendoset përmes një aktvendimi mbi pjesëmarrjen e CB-it si palë e tretë në Ac.nr. 1469/12 të Gjykatës së Apelit. Së fundi, sipas Nenit 271, paragrafi 2 i LPK-së *pala e tretë mund ti bashkohet procedurave gjatë tërë rrjedhës së tyre gjersa të përfundojnë nga një vendim përfundimtar mbi padinë, si dhe gjatë procedurave të iniciuara me rastin e parashtrimit të një mjeti të jashtëzakonshëm juridik.* Në këtë rast, asnjë nga këto kushte alternative për ndërhyrjen e CB-it si palë e tretë, nuk janë përbushur. Ankesa e KOMUNËS së Podujevës që térhequr sipas Nenit 177, paragrafi 2 i LPK-së dhe ishte hedhur poshtë si e palejueshme për shkak të térheqjes sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika a), Neni 196 dhe Neni 186, paragrafi 3, hipoteza e tretë e LPK-së, nga pika I e dispozitivit të këtij aktvendimi. Ky vendim i gjykatës së

shkallës së dytë nuk mund të ankimohet ( Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së)-prandaj, me lëshimin e saj në procedurën e shkallës së dytë në AC.nr. 1469/12 të Gjykatës së Apelit, në pjesën e saj të pranueshme ishte përfunduar e cila ka shpënë automatikisht në futjen në fuqi të aktgjykimit C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, të datës 2 Shkurt 2009, e kundërshtuar nga ky mjet juridik i rregullt që veq ishte tërhequr. Meqë kjo *procedurë kontestimore ka qenë e përfunduar kështu nga një aktgjykim final mbi padinë* e RSM për të drejtën e pronësisë mbi banesën nr.20. kati II, hyrja nr.2, me një sipërsaqe prej 52.51 m<sup>2</sup> në Rrugën “ Zahir Pajaziti” Ndërtesa P+5/7, Podujevë, sipas Nenit 271, paragrafi 2, fjalia e parë e LPK-së, mund të mos bashkohet në nivel të apelit nga ndonjë person fizik apo juridik si palë e tretë, duke e përfshirë CB-in. Një *ndërhyrje* e tillë (*bashkim*) është i lejueshëm vetëm derisa është një gjykim *në pritje* dhe është *vice versa* i palejueshëm pas gjykimit, duke qenë i përfunduar përmes një aktgjykimi final mbi padinë, nuk është më *në pritje* në shkallë të parë apo të dytë. Deri më tanë nuk ka asnë mjet të jashtëzakonshëm juridik e cila e përjashton ndërhyrjen (*bashkimin*) e cilësdo palë të tretë, duke përfshirë CB-in, nën kushtet e dhëna në Nenin 271, paragrafi 2, hipoteza e dytë e LPK-së. Për arsyen e njëjtë- mungesa e një procedure në vazhdim të shkallës së parë apo të dytë, e pa përfunduar nga një vendim përfundimtar mbi padinë, apo një mjet i jashtëzakonshëm juridik i aplikuar, *implikimi* i CB-it si palë e tretë sipas Nenit 276 të LPK-së nga cilido prej palëve ndërgjygjëse në këtë rast, përpos që nuk është kërkuar, është po aq e palejueshme ashtu siq është ndërhyrja sipas Nenit 271, paragrafi 1 i LPK-së mbi bazat e iniciativës së tij. Si përbledhje, CB *nuk është bërë një palë e tretë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shkallën e dytë* - legjitimiteti i tij i një ankimuesi në AC.nr.1469/12 të Gjykatës së Apelit nuk mund të bazohet në këtë *status procedural* të *pa-fituar* të një pale të tretë sipas Nenit 271, paragrafi 1 apo Neni 276 i LPK-së gjersa ankesa e tij kundër aktgjykimit C.nr.407/08 e Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009 ka mbetur ashtu siq është parashtruar fillimisht *pa të drejtën e palës së tretë që ta shfrytëzojë këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik*, sipas Nenit 273, paragrafi 3 i LPK-së. Së terti asnë nga bazat alternative në Nenin 269, paragrafi 1 i LPK-së nuk ekzistojnë për *bashkëndërgjygjësi* në këtë rast-as sipas ligjit, e as sipas natyrës së marrëdhëniec ligjore që e ka kontesti në të që të zgjidhet në të njëjtën mënyrë në lidhje me RSM dhe CB apo në lidhje me KOMUNËN e Podujevës dhe CB-in. Kjo është arsyja se përse ata nuk mund të konsiderohen *palë e vetme* e cila e përjashton mundësinë e një veprimi procedural të ndonjërsë nga palët kryesore që të zgjerohet tek CB si palë e saj bashkëndërgjygjëse që ka dështuar ta ndërmarrë atë sipas Nenit 269, paragrafi 1 i LPK-së. Në veçanti, e *pa-aplikueshme* është rregulla që rrjedh nga Neni 269, paragrafi 1 i LPK-së se *të gjithë bashkëndërgjygjësit, duke e pasur* të

*garantuar me ligj pjesëmarrjen e tyre në shqyrtimin kryesor si palë kryesore, e kanë të drejtën e ankesës ndaj aktgjykimit të lëshuar pa pjesëmarrjen e tyre në procedurë të shkallës së parë. Në mungesë të bashkëndërgjygjësisë, ankesa e KOMUNËS së Podujevës nuk qe zgjeruar tek CB sipas Nenit 269, paragrafi 1 i LPK-së dhe kjo normë nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për konstituimin e saj *ex officio* nga gjykata e shkallës së dytë në procedurat e apelit, pa marrë parasysh mos-pjesëmarrjen e tij në C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës. Kjo automatikisht e përjashton mbizotërimin e ankesës së tij të pa-tërhequr mbi ankesën e tërhequr të KOMUNËS së Podujevës sipas Nenit 269, paragrafi 2 i LPK-së. Meqë KOMUNA e Podujevës dhe CB nuk janë bashkëndërgjygjës, legjitimiteti procedural i CB-it për ta kundërshtuar aktgjykimin C.nr. 407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, të datës 2 Shkurt 2009, nuk mund të nxirret nga ankesa e KOMUNËS së Podujevës - në funksion të mos-zbatimit të Nenit 269, paragrafi 1 i LPK-së, asnjëherë nuk e ka zgjeruar efektin e saj ligjor tek CB. Në përbledhje, CB, nuk është bërë ankues bazuar në *cilësinë e tij të palës në procedurë të shkallës së parë* duke e ankimuar aktgjykimin C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, të datës 2 Shkurt 2009, sipas Nenit 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së; ai nuk është bashkuar në AC.nr.1469/2012 të Gjykatës së Apelit *duke ndërhyrë si palë e tretë* për shkak të përfundimit të procedurës nga një vendim përfundimtar mbi padinë pas tërheqjes së ankesës së KOMUNËS së Podujevës sipas Nenit 271, paragrafi 2 i LPK-së; së fundi, ai nuk është bërë parashtrues i ankesës në AC.nr. 1469/12 të Gjykatës së Apelit nga *bashkëndërgjygjësia* për shkak të zgjerimit të ankesës së KOMUNËS së Podujevës tek ai sipas Nenit 269, paragrafi 1 i LPK-së dhe/apo të pezullojë tërheqjen e saj sipas Nenit 269, paragrafi 2 i LPK-së.*

**28.** Andaj, ankesa e CB kundër aktgjykimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009 është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3, hipoteza e parë e LPK-së *si e parashtruar nga një person që nuk është i autorizuar që ta parashtrojë atë*. Pa qenë palë në procedurën e shkallës së parë dhe/apo të dytë, CB nuk ka pasur të drejtën në këtë mjet juridik të akredituar nga Neni 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së, shprehimisht dhe restriktivisht për palët vetëm në çështjen gjyqësore në fjalë. Duke mos pasur këtë cilësi të obligueshme të palës, CB nuk ka qenë i legjitimuar që ta ankimojë aktgjykimin C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, të datës 2 Shkurt 2009, ndërsa ankesa e tij është e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3, hipoteza e parë e LPK-së dhe do të hedhet poshtë në pajtim me Nenin 195, paragrafi 1, pika a) dhe Neni 196 i LPK-së.

**29.** Ankesa e CB është po ashtu e palejueshme sipas Nenit 186, paragrafi 3, hipoteza e fundit e LPK-së sepse ka qenë e parashtruar *pa interes juridik* në

aktgjykimin e kundërshtuar C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009, edhe pse e obligueshme sipas Nenit 2, paragrafi 4 i LPK-së për çdo veprim procedural të ndërmarrë në procedurë kontestimore. *Së pari, sipas Nenit 167, paragrafi 1 LPK-së Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, përvèç kur nga shkaku i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë.* Asnjëra nga këto dy alternativa nuk ekziston në lidhje me CB. Meqë ai nuk ka qenë një palë në procedurën e shkallës së parë, aktgjykimi C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009 *nuk ka prodhuar ndonjë efekt juridik për të nën kushtet e dhëna të Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së.* Për aq kohë sa fushëveprimi subjektiv i padisë - lënda në C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës nuk ishte tejkaluar nga aktgjykimi i lëshuar në shkallë të parë, *res judicata* e saj sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë dhe Neni 166, paragrafi 1 i LPK-së është e kufizuar për RSMN dhe të paditurën KOMUNËN e Podujevës. Duke pasur parasysh këto kufizime subjektive të *res judicata*'s formuar nga aktgjykimi C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009, *nuk ka fuqi ligjore tek personat e tretë siq është CB - që nuk janë palë në rast, sipas Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë dhe Neni 166, paragrafi 1 i LPK-së.* As për shkak të natyrës së marrëdhënies së kontestit në këtë rast, e as bazuar në ndonjë nga dispozitat ligjore, efekti juridik i aktgjykimit C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009 mund të konsiderohet si i zgjeruar tek CB si person i tretë nën kushtet e Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e dytë e LPK-së. Domethënë, një zgjerim i tillë nuk mund të arsyetohet me *vazhdimesi juridike* meqë nuk është shfaqur në asnjë formë gjatë procedurave në mes të ndonjëres nga palët dhe CB-it. Në veçanti, banesa e kontestuar nuk ishte tjetërsuar në asnjë fazë të procedurës në shkallë të parë dhe/ose të dytë nga ndonjëri prej palëve ndërgjygjëse tek CB-i, në hipotezën e Nenit 263, paragrafi 1 i LPK-së - prandaj, aktgjykimi C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009 nuk mund të ketë pasoja ligjore mbi CB-in si fitues i këtij objekti ndërgjygjësor gjatë procedurave bazuar në Nenin 263, paragrafi 3 i LPK-së. Zgjerimi i *res judicata*-s i aktgjykimit C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009, po ashtu nuk mund të rrjedhë nga varësia e gjendjes ligjore e CBt me atë të RSM apo KOMUNËS së Podujevës meqë ata nuk janë të pavarur dhe jo aksesorial për njëri tjetrin. Meqë nuk ka asnjë *bashkëndërgjygjësi* për të drejtën e pronësisë së banesës së kontestuar në mes të CB dhe asnjërit nga palët ndërgjygjëse në C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, efekti juridik i aktgjykimit të lëshuar nuk mund të zgjatet tek CB sipas Nenit 269, paragrafi 1 LPK-së, pa marrë parasysh pjesëmarrjen e tij të pandërprerë në procedura të vendosura nga ajo. Nuk mund të ketë zgjerim *res*

*judicata* bazuar në Nenin 168 të LPK-së meqë nuk ka pasur *asnje ndërmjetësim* në C.nr.407/08 të Gjykatës Komunale të Podujevës, *inter alia*, në mes të ndonjërit nga palët ndërgjygjëse në rast dhe CB-it. Kontesti në C.nr. 407/2008 i Gjykatës Komunale të Podujevës, nuk është mbi statusin ligjor të palëve dhe andaj zgjidhja e saj nuk është mbi bazat e *erga omnes*. Së fundi, asnje dispozitë ligjore nuk e zbaton efektin juridik të një aktgjykimi përfundimtar mbi çdo kontest pronësor tek personat e tretë, mos-pjesëmarrës në gjykimin e saj. Për të gjitha këto arsy, CB nuk është i detyruar ligjërisht nga aktgjykimi C.nr.407/08 i Gjykatës Komuanle të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009, as në bazë të Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së (*duke pasur parasysh mungesën e cilësisë së palës në procedurë*), e as në bazë të Nenit 167, paragrafi 1, hipoteza e dytë e LPK-së (*duke pasur parasysh mungesën e veçantitë e të drejtës kontestimore dhe / ose një dispozite që zgjeron fushëveprimin subjektiv të vendimit për ata që nuk janë palë*). Së dyti, për sa kohë që aktgjykimi C.nr.407/08 i Gjykatës Komunale të Podujevës, i datës 2 Shkurt 2009, nuk aplikohet për CB-in, pa qenë i adresuari i *res judicat's* së saj ai mbetet në tërësi me të drejtën që të parashtrojë një padi pronësore për banesën në lidhje me pronësinë e tij të pretenduar kundër çdo personi, duke e kontestuar atë, duke përfshirë palët në C.nr.407/2008 të Gjykatës Komuanle të Podujevës. Nëse e inicuar, një procedurë e tillë e re kontestimore nuk do të ishte e pa-pranueshme sipas Nenit 391, pika d) e LPK-së mbi bazën e *res juridicata's* meqë kontesti pronësor në C.nr.407/2008 i Gjykatës Komuanle të Podujevës është zgjidhur vetëm në mes të RSM dhe KOMUNËS së Podujevës dhe *vice versa* ka mbetur i pagjikuar në këtë rast në lidhje me CB-in. Parashtimi i një padie të re pronësore nga CB nuk mund të pengohet proceduralisht nga *parashkrimi* meqë nuk ka një afat të tillë i caktuar me ligj. Të gjitha kufizimet kohore nën Nenet 371 - 380 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së No. 29/78, amendamentet në No. 39/85, 45/89, 57/89 dhe në Gazetën Zyrtare të RFJ-së No. 31/93), si dhe nën Nenet 352 - 362 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (Gazeta Zyrtare Nr.16/12), në fuqi që nga data 20 Nëntor 2012, janë të përshkruara për pazbatueshmërinë e padive për *përbushjen e detyrimeve*, kontraktuale-jokontraktuale në thelb dhe *vice versa* nuk zbatohen për të *drejtat pronësore*. Kjo e fundit duke qenë absolutisht në natyrë me ndalesën *erga omnes* sipas Nenit 2, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore (Gazeta Zyrtare Nr. 57/09) për tu abuzuar *nuk i nënshtrohen asgjësimit*, gjersa e *drejta e tyre procedurale* për të kërkuar *mbrojtjen e tyre ligjore para gjykatës kompetente* nuk mund të skadojë ose përndryshe të bëhet ligjërisht e vjetruar. Së treti, aktgjykimi C.nr.407/2008 i Gjykatës Komunale në Podujevë, i datës 2 Shkurt 2009 nuk ndikon apo dëmton në asnje mënyrë efektin juridik të Vendimit No. HPCC/REC/60/2006 të

KKPB-së me datë 31 Mars 2006 duke e aprovuar kërkesën e CB për rikthimin si mbajtës i së drejtës pronësore në posedim të banesës nr.123 në Podujevë, Rruga “JNA”, nr.10, sipas Nenit 1.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/23 dhe Nenit 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/60. Vendimi No. HPCC/REC/60/2006 duke qenë përfundimtar mbetet në tërësi i detyrueshëm dhe në fuqi dhe nuk i nënshtrohet rishqyrtimit nga asnje gjykatë apo autoritet administrativ në Kosovë, sipas Nenit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.1999/23.

**30.** E drejta për tu ankuar duke qenë rezultat i së drejtës për mbrojtje në procedurë civile kontestimore u takon vetëm *palëve* në këtë rast me *interes juridik* në kundërshtimin e aktgjykimit të lëshuar mbi të si duke ndikuar negativisht të drejtën (at) e tyre materiale dhe /apo interesin(at). Me anë të këtij mjeti juridik të zakonshëm, pala e pakënaqur me rezultatin në shkallë të parë, e inicion ankesën para gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë që të pranojë një vendim më të favorshëm mbi kontestin. Andaj, në mesin e parakushteve tjera të pranueshmërisë, ankesa duhet që te jetë e lejueshme e parashtruar nga pala e cila ka të drejtë që ta kundërshtojë aktgjykimin e shkallës së parë sipas Nenit 176, parografi 1, fjalia e parë e LPK-së dhe ka interesin juridik të kërkuar nga Neni 2, paragrafi 4 i LPK-së. Në kundërshtim me këto kërkesa obligative, ankesa e CB-it kundër aktgjykimit C.nr.407/2008 të Gjykatës Komunale të Podujevës, e datës 2 Shkurt 2009, është *parashtruar nga një person pa të drejtë dhe pa interes juridik*. E palejueshme mbi këto baza të Nenit 186, paragrafi 3, hipoteza e parë dhe e fundit e LPK-së do të hedhet poshtë në bazë të Nenit 195, paragrafi 1, pika a) dhe Neni 196 i LPK-së.

### **III. SHPENZIMET PROCEDURALE**

**31.** Kur gjykata e shkallës së dytë hedh poshtë ankesën kundër një aktgjykimi, sipas Nenit 465, paragrafi 1 i LPK-së duhet po ashtu të vendosë edhe në lidhje me shpenzimet në procedurë të apelit. Sidoqoftë, asnje vendim i tillë nuk do merret këtu meqë nuk ka një kërkesë të posaçme të parashtruar sipas Nenit 463, paragrafi 1 i LPK-së për reimbursimin e shpenzimeve të tilla nga ndonjëra palë në AC.nr.1469/12 të Gjykatës së Apelit. Në veçanti RSM nuk pretendon shpenzimet në procedurën e shkallës së dytë sipas Nenit 463, paragrafi 1 i LPK-së, dhe as nuk i ka specifikuar apo evidentuar ato sipas Nenit 463, paragrafët 2 dhe 3 të LPK-së, KOMUNA e Podujevës, pa marrë parasysh tërheqjen e ankesës së saj nuk është përgjegjëse për pagesën e tyre sipas Nenit 456, paragrafi 2 i LPK-së. CB nuk ka të drejtë për asnje shpenzim procedural duke mos qenë palë në këtë rast, në pajtim me Nenet 449 - 451 të LPK-së dhe në funksion të hedhjes poshtë të ankesës së tij, në pajtim me Nenin 452, paragrafi 1 i LPK-së.

Në funksion të arsyetimit të mësipërm është vendosur si në dispozitiv.

**KËSHILLË LIGJORE:** Nuk lejohet ankesa kundër aktvendimit në përputhje me Nenin 296, paragrafi 1 *in fine* në lidhshmëri me Nenin 208 dhe Nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së.

**GJYKATA E APELIT – PRISHTINË**  
**AC.nr.1469/2012 me datë 02.08.2013**

---

**KRYETARE E TRUPIT GJYKUES  
GJYQTARE ROSITZA BUZOVA**

*Përpiluar në gjuhën angleze si gjuhë zyrtare në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*